



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË: 14 DHJETOR 2010
NR. REF.: AGJ 67/10

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI 09/10

Parashtrues i kërkesës

Kimete Bikliqi

kundër

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Miraton Aktgjykimin në vijim:

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është znj. Kimete Bikliqi nga Janjeva, Lipjan.

Pala kundërshtare

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), i themeluar në pajtim me Nenin 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Çështja e lëndës

3. Më 27 janar 2010, znj. Kimete Bikliqi parashtroi kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila u regjistrua me numrin KI-09/10. Parashtruesja e sfidoi vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të 14 dhjetorit 2009, për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 15 nëntor 2009. Në veçanti, parashtruesja pohon se janë shkelur këto dispozita: Neni 45, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 232, paragrafi (c) dhe (g) i Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, dhe nenet 106 dhe 117 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Baza juridike

4. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm - Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm - Ligji), dhe Neni 55 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm - Rregullorja e punës).

Përmbledhje e procedurave para Gjykatës Kushtetuese

5. Kërkesa është parashtruar pranë Gjykatës Kushtetuese më 27 janar 2010. Kryetari i Gjykatës e emëroi Prof. Dr. Ivan Čukalovićin Gjyqtar raportues dhe emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Mr. Kadri Kryeziu, kryesues, Prof. Dr. Enver Hasani dhe Dr. Iliriana Islami. Gjykata shqyrtoi pranueshmërinë e kërkesës së parashtruesit.

Faktet

6. Parashtruesja, kandidate për Kuvendin Komunal në Lipjan gjatë zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009, pohon se KQZ ka ndërhyrë në mënyrë të kundërligjshme me votat e hedhura për të gjatë zgjedhjeve lokale. Sipas rezultateve paraprake të shpallura nga KQZ, parashtruesja kishte fituar 132 vota, dhe duke qenë e listuar si kandidate më numër 18 në listën e kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës, ajo, sipas atij rezultati kishte siguruar pozitën e deputetit të Kuvendit Komunal në Lipjan.
7. Pas përfundimit të tërë procesit dhe publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga ana e KQZ-së më 14 dhjetor 2009, dhe në pajtim me Nenin 106, paragrafi 3, të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, dukej se parashtruesja kishte grumbulluar gjithsej 131 vota dhe si rrjedhojë, pozita e deputetit të Kuvendit komunal i ishte ndarë një personi tjetër që kishte fituar numër të njëjtë të votave, 131, por i cili ishte radhitur më lartë në listën e kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës, partinë e parashtrueses.
8. Më 16 dhjetor 2009, parashtruesja u ankua në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), duke shprehur shqetësimin e saj për përjashtim nga lista e rezultateve përfundimtare e publikuar nga KQZ më 15 dhjetor 2009, dhe duke kërkuar përmirësimin dhe konfirmimin e votave të saj. Më 21 dhjetor 2009, KZAP-i nxori Vendimin A.nr.477/2009 përmes të cilit e hodhi ankesën poshtë si të pabazuar.
9. Më 11 janar 2010, znj. Bikliqi parashtroi ankesë me shkrim në KZAP bashkë me dëshmi të reja dhe kërkoi shqyrtimin e vendimit të KZAP-it A.nr.477/2009, të datës 21 dhjetor 2009. Më 21 janar 2010, KZAP-i lëshoi Vendimin A.no.06/2010 me të cilin hodhi poshtë ankesën si të pabazuar.

10. Më 21 dhjetor 2009, znj. Bikliqi u ankua në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit të KZAP-it A.no.477/2009. Gjykata Supreme e Kosovës, në aktgjykimin e saj A.no.995/2009, të 29 dhjetorit 2009, theksoi se “pas shqyrtimit të pohimeve të ankesës dhe të gjitha dokumenteve të rastit lidhur me këtë çështje, konstatoi që ankesa është e pabazuar”. Në të njëjtin vendim, Gjykata Supreme tha që “KQZ-ja, pas përfundimit të të gjitha procedurave në qendrat e votimit dhe në qendrat e numërimit, dhe pasi u informua se KZAP-i ka vendosur për të gjitha vërejtjet që kanë të bëjnë me votim dhe numërim, i certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve më 14 dhjetor 2009 në orën 18:45. Dispozitat e Nenit 119.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (LZPK) parashohin që ankesa kundër vendimeve të KQZ-së mund të paraqitet vetëm nëse vendimet e tilla ndikojnë në të drejtat ligjore të përmendura në atë nen. Mospërputhja e rezultateve paraprake me rezultatet përfundimtare nuk është e shënuar si njëra prej arsyeve për të paraqitur ankesë kundër vendimeve të KQZ-së, prandaj ankesa e parashtrueses ishte e papranueshme, sipas vlerësimit të Gjykatës, e paditura ligjërisht e ka zbatuar Nenin 118 të LZPK-së me rastin e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të vet”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

11. Për ta gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari ka shqyrtuar dokumentacionin në dispozicion si dhe nëse parashtruesi i ka përmbushur kërkesat për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

12. Nga dokumentacioni i parashtruar, Gjykata konstaton se parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, përfundimisht me ankesën e hedhur poshtë nga Gjykata Supreme.

13. Neni 48 i Ligjit përcakton se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

14. Parashtruesja pretendon se janë shkelur të drejtat e saj të përcaktuara me Nenin 45 të Kushtetutës, nenet 106 dhe 107 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Nenin 232 (c, g) të Ligjit të Procedurës Kontestimore 03/L-006.

15. Neni 49 i Ligjit përcakton se:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

16. Kërkesa e parashtrueses është pranuar në Gjykatën Kushtetuese më 27 janar 2010, ndërsa vendimi i fundit në lidhje me këtë rast është lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, më 29 dhjetor 2009. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa është parashtruar në pajtim me Nenin 49 të Ligjit.

17. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se janë përmbushur kriteret ligjore dhe se Kërkesa është e pranueshme.

Zgjedhjet

18. Në rastin e mëhershëm të znj. Mimoza Kusari, KI- 73/09, të publikuar më 18 mars 2010, Gjykata Kushtetuese ka theksuar rëndësinë e zgjedhjeve në një shoqëri demokratike. Në këtë aktgjykim vlen të përsëriten dhe theksohen disa nga aspektet e rëndësishme që kjo Gjykatë i ka cekur në atë rast.

1. Neni 45 i Kushtetutës së Kosovës përcakton:

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.
2. Sipas Nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokolleve të saj janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Ato përbejnë pjesën e së Drejtës Kombëtare. Neni 3 i Protokollit të Parë siguron të drejtën për zgjedhje të lira. Siguron se zgjedhje të lira do të mbahen "... me intervale të arsyeshme me votim të fshehtë, në kushte të cilat do të sigurojnë shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve".
3. Neni 123.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron se ' Vetëqeverisja Lokale ushtrohet nga organe përfaqësuese që zgjidhen me ane të zgjedhjeve të përgjithshme, të lira, të barabarta, direkt dhe të fshehta'. Kuvendi i Kosovës ka siguruar një mekanizëm për mbajtjen e Zgjedhjeve të Përgjithshme dhe Lokale duke miratuar Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji Nr. 03/L-073 në Republikën e Kosovës dhe Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040.
4. Gjykata ka theksuar se e drejta për të votuar është e drejtë aktive dhe e drejta për tu zgjedhur është e drejtë pasive. Parashtruesi i kërkesës mban qëndrimin se e drejta e saj për tu zgjedhur është shkelur. Megjithatë, ka një ndryshim midis të drejtës për tu zgjedhur dhe të drejtës për të kandiduar në zgjedhje. Jurisprudenca e GJEDNJ tregon se ekziston një liri veprimi e konsiderueshme që shtetet kanë në sistemin e tyre elektorale dhe ata lejojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi lidhur me mënyrën që janë zhvilluar zgjedhjet dhe se si shpallen rezultatet e zgjedhjeve. Në rastin e Partisë Komuniste të Bashkuar të Turqisë vs Turqia, Gjykata theksoi se '(shtetet) kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë sferë, por është Gjykata, si mundësia e fundit, e cila vendosë nëse kërkesat e Protokollit të Parë janë pajtuar; ajo kënaqet kur kushtet e vena nga shtetet nuk zvogëlojnë të drejtat në fjalë dhe deri diku nuk dëmtojnë thelbin e tyre ashtu që t'i privojnë këto të drejta nga efektiviteti i tyre; kur ato kërkesa e kushte të vëna nga shtetet imponohen në ndjekje të një qëllimi legjitim; kur

mjetet që përdoren nuk janë në disproporcion (shihni Sadek and Others (no.2) vs Turkey, no.25144/94 et al, 31, ECHR 2002-IV).

5. GJEDNJ ka shprehur vazhdimisht rëndësinë e zgjedhjeve të lira dhe të demokracisë në aktgjykimet e saj. Në të njëjtin aktgjykim, Gjykata shprehu mendimin e saj për si vijon: 'Demokracia paraqitet si modeli i vetëm politik i parashikuar nga Konventa dhe, për pasojë, i vetmi që pajtohet me të'. GJEDNJ, në të njëjtin aktgjykim citoi me miratim Kodin e Praktikës së Mirë, i aprovuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në seancat e 51 (Udhëzimet) dhe 52 (Raporti) me 5-6 korrik dhe 18-19 tetor 2002 (Opinion nr. 190/2002, CDL-ADN(2002) 23 RTV). Komisioni Venecias me këtë rast deklaroi:

“Pese parimet mbi të cilat mbështetet trashëgimia zgjedhore e Evropës janë se zgjedhjet duhet të jenë: universale, të barabarta, të lira, të fshehta dhe përmes një votimi të drejtpërdrejt. Përveç kësaj, zgjedhjet duhet të mbahen në intervale të rregullta”.

6. Komisioni i Venecias vë në dukje se organizimi i zgjedhjeve duhet të mbikëqyret nga një organ i pavarur, përgjegjës për aplikimin e ligjit zgjedhor dhe që të ketë një sistem efektiv apeli. Sipas ligjit në Kosovë, këto dy funksione kryhen respektivisht nga KQZ-ja dhe KZAP-i, me të drejtën për ankesë/apel në gjykatë në rastet e parashikuara nga ligji. Vetëm këto dy janë organet të cilat vendosin për të gjitha çështjet lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve, certifikimi të rezultateve dhe kush gjykon mbi ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, siç parashihen me ligj dhe rregullat zgjedhore. Këto janë organe të përhershme e të pavarura.
7. Arsyetimi që KQZ dhe KZAP-i kane këto autorizime dhe përgjegjësi, mbështetet në supozimin se duhet të ketë siguri në procesin e zgjedhjeve. Nevoja e sigurisë në procesin zgjedhor kërkon anulimin e zgjedhjeve vetëm në rastet e shkeljeve më serioze dhe barra e vështirë e të provuarit bie mbi këdo që pretendon për kesi lloj shkeljesh“.

Ligji për Zgjedhjet në Kosovë

19. Ligji për organizimin e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës qeveriset nga Ligji 03/L-073, Ligji për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligji nr. 03/L-072, Ligji për Zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës. Neni 26 i Ligjit për Zgjedhjet lokale përcakton:

Neni 26

Kreu XVI (Procesi i numërimit të fletëvotimeve dhe shpallja e rezultateve të zgjedhjeve), dhe çfarëdo dispozite e ndërlidhur me këtë çështje e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, mutatis mutandis, vlejnë për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.

20. Neni 101 i Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme përcakton dispozitat e përgjithshme për numërimin e fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve dhe i jep kompetenca KQZ-së për hartimin e rregullave përkatëse. Ai përcakton si në vijim:

Neni 101

Dispozitat e përgjithshme

101.1 Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërimin dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës.

101.2 Fletëvotimet e rregullta nga vendvotimet përbrenda Kosovës numërohen në po ato vendvotime, menjëherë pas mbylljes së procesit votues.

101.3 Procedurat e numërimit janë në pajtim me rregullat e KQZ-së.

21. KQZ-ja i ka hartuar rregullat që administrojnë shumë aspekte të zgjedhjeve. I pari i këtyre ishte rregulli zgjedhor Nr. 01/2008, për regjistrimin dhe operimin e partive politike që hyri në fuqi më 29 qershor 2009. Më i fundit ishte rregulli zgjedhor Nr. 15/2010 lidhur me zgjedhjet e parakohshme dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme që hyri në fuqi më 2 mars 2010.
22. Rregulli më i rëndësishëm në lidhje me këtë rast është rregulli zgjedhor Nr. 09/2009 për Votimet dhe numërimin brenda vendvotimeve në nivel të komisionit komunal të zgjedhjeve, që hyri në fuqi më 25 qershor 2009. Këto rregulla qeverisin proceset për numërimin e fletëvotimeve dhe për numërimin dhe përputhjen e fletëvotimeve me kusht. KZAP-i trajton ankesat në lidhje me procesin e votimit. Parashtruesja ka parashtruar apel në KZAP në lidhje me ankesën e saj, dhe ajo u hodh poshtë nga KZAP-i dhe më pas nga Gjykata Supreme. Parashtruesja nuk ishte në gjendje të theksojë në cilin vend të tërë procesit ka ekzistuar shkelja e Ligjit apo Rregullave që kanë prekur të drejtat e saj kushtetuese.
23. Gjykata shfrytëzon këtë mundësi të përsëritë dispozitat e nenit 53 të Kushtetutës që obligon Gjykatën të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në pajtim me vendimet e GJEDNJ-së. Ky nen përcakton si në vijim:

Neni 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut]

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

24. Në rastin Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 9267/81, GJEDNJ thekson se Shtetet Kontraktuese e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë marginë të gjerë të vlerësimit, duke pasur parasysh se legjislacioni i tyre për këtë çështje ndryshon nga vendi në vend dhe nga koha në kohë. Sistemet zgjedhore kërkojnë të përmbushin objektivat që disa herë pothuajse nuk janë në përputhje me njëra-tjetrën: në një anë, të pasqyrojnë mjaft drejtë mendimet e njerëzve, dhe në anën tjetër, të kanalizojnë rrjedhat e mendimit ashtu që të promovojnë shfaqjen e një vullneti politik mjaft të qartë dhe koherent. Në këto rrethana, fraza “kushtet që do të sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të njerëzve në zgjidhjen e legjislaturës” në thelb nënkupton – krahas lirisë së shprehjes (veçse të mbrojtur me nenin 10 të Konventës) (neni 10) – parimin e barazisë së trajtimit të të gjithë qytetarëve në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe të drejtës së tyre për t’u zgjedhur.
25. Në po këtë vendim, GJEDNJ thekson: ‘Megjithatë, nuk do të thotë që të gjitha votat duhet medoemos të kenë peshë të barabartë për sa i përket përfundimit të zgjedhjeve apo se të gjithë kandidatët duhet të kenë shans të barabartë për të fituar. Prandaj, asnjë sistem zgjedhor nuk mund t’i eliminojë “votat e humbura”.
26. Gjithashtu, Gjykata thekson se në çfarëdo shqyrtimi të sistemit zgjedhor në fjalë, nuk duhet të harrohet konteksti i tij i përgjithshëm. Sistemi nuk duket të shfaqet i paarsyeshëm nëse i kushtohet kujdes synimeve që i pasqyrojnë dhe marginës së

vlerësimit të shtetit të paditur brenda sistemit parlamentar Belg – marginë e cila është më e madhe nëse sistemi është i paplotë dhe i përkohshëm.

27. GJEDNJ përfundimisht vendosi në këtë rast se nuk kishte kufizim disproporional që do të mund të parandalonte “shprehjen e lirë të opinionit të popullit në përzgjedhjen e legjislaturës”.
28. Roli i Gjykatës Kushtetuese në procesin zgjedhor pranohet me Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme, dhe Neni 106.1 përcakton që KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala, që u përkasin votimit dhe numërimit, janë vendosur nga Komisioni Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa dhe nga Gjykata Kushtetuese. Gjykata nuk asnjë rol tjetër në procesin zgjedhor përveç se të gjykojë për çështjen nëse ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë. Në këtë rast, parashtresuesi nuk ishte në gjendje të dëshmojë se në cilën pjesë të tërë procesit ka pasur shkelje të ligjit apo rregullave që i kanë prekur të drejtat e saj kushtetuese.
29. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, me rastin e shqyrtimit të vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
30. Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka marginë të gjerë të vlerësimit në mënyrën në të cilën, përmes ligjeve të saj, siguron organizimin e zgjedhjeve të drejta dhe të lira, si dhe duke pasur parasysh se parashtresuesja nuk ishte në gjendje të theksojë shkeljen e ligjit apo të Kushtetutës që ka prekur të drejtat e saj kushtetuese, Gjykata konstaton se nuk pasur shkelje të të drejtave të saj.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me Nenin 113 (7) të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit dhe Nenin 55 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 14 dhjetor 2010, me shumicë votash, merr:

VENDIM

- I. Kërkesa është e pranueshme.
- II. Nuk ka pasur shkelje të të drejtave, siç pohohet nga parashtresuesja.
- III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20(4) të Ligjit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Prof. Dr. Ivan Čukalović, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.